



08 Maj 2019

Thirrje e hapur për pjesëmarrje në grupe lokale konsultative

Në kuadër të zbatimit të projektit “**Një qasje sektoriale për kontributin e shoqërisë civile në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian të Shqipërisë,**” Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim (CDI) shpall thirrjen për ngritjen e 3 grupeve të konsultimit nga qytetet pilote të projektit (*Shkodër, Korçë dhe Vlorë*), të cilët do të bëjnë të mundur ngritjen e zërit të komunitetit lokal dhe angazhimin e tyre në kuadër të procesit të integritimit evropian. Grupet rajonale konsultative (*të përbëra nga OJF dhe grupe të tjera interesi*) duhet të kenë në fokus të punës së tyre integrimin evropian dhe angazhimin rinor në politikëbërje. Pjesëmarrësit do të advokojnë për përfaqësimin dhe përfshirjen e interesave të komuniteteve lokale në politika që prekin këto tre qytete.

Informacion i përgjithshëm

Projekti “**Një qasje sektoriale për kontributin e shoqërisë civile në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian të Shqipërisë**” është projekti më i ri i Institutit për Bashkëpunim dhe Zhvillim (CDI), që synon nxitjen e politikave të dialogut dhe ndërgjegjësimin të shoqërisë mbi procesin e Integritimit Evropian.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të mbështesë politikën e bazuar në evidenca që nxisin një dialog midis organizatave jofitimprurëse dhe qeverisë shqiptare, dhe përfshirjes së tyre në politikëbërje.

Ky projekt mbështetet nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë nëpërmjet Ministrisë të Ekonomisë dhe Financave në Shqipëri/CFCU dhe po zbatohet në bashkëpunim me Fondacionin Friedrich Ebert (Tiranë) dhe Centar Savremene Politike/European Western Balkans (Beograd).



Qëllimi dhe objektivat

Grupet e konsultimit do të mbështetet nga projekti CONNECT dhe do të bashkëpunojnë me koordinatorët e BE-së në Bashkitë e qyteteve të projektit. Fokusi i këtyre takimeve do të jetë:

- Përforcimi i dialogut dhe bashkëveprimit ndërmjet bashkive dhe grupeve të konsultimit në kuadër të integritimit evropian dhe fondeve që mund të përfitohen nga BEja;
- Diskutimi mbi prioritetin tematik të vendosur për secilin qytet me përfaqësues të pushtetit qendror dhe si ky prioritet trajtohet në kuadër të procesit të negociatave;
- Diskutimi mbi mënyrën se si ky grup do të funksionojë dhe realizojë pjesëmarrjen në vendimarrje.

Gjetjet dhe rezultatet e takimeve do të jenë pjesë e një analize e cila do të prezantohet në një aktivitet të posaçëm, me fokus fuqizimin e dialogut shoqëror për politika sektoriale transparente dhe gjithëpërfshirëse.

Profili i pjesëmarrësve

- Përfaqësues të shoqërisë civile, grupeve rinore, akademikë, hulumtues, ekspertë, gazetarë dhe studentë të interesuar dhe të përfshirë në procesin e integritimit evropian në nivel lokal.
- Të veprojnë në qytetet Shkodër, Korçë dhe Vlorë.

Procesi i aplikimit

- Individët e interesuar duhet të dërgojnë një email ku shprehin arsyet për të marrë pjesë në këto grupe në adresën: connect@cdinstitute.eu
- Afati i aplikimit **19 Maj, 2019!**